



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2025

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: **Ministria e Arsimit dhe Sportit**

Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 23

Tel/Fax: 04 2226955, Fax 04232002

Faqja e Internetit: www.arsimi.gov.al

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim larje për automjetet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.

Data e zhvillimit do të jetë 02.06.2025, ora 10:00, në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me të dhëna dhe specifikimet teknike si më poshtë:

Të dhënat dhe specifikimet teknike të shërbimit:

Nr.	Emërtimi shërbimit	Njësia	Sasia
1	Shërbim larje automjete “Audi A8”, Toyota “RAV4”, “Volvo XC60”	Larje/muaj	30
2	Shërbim larje automjeti “Hyundai Getz”	Larje/muaj	4
3	Shërbim larje automjeti “Toyota Prius”	Larje/muaj	4
4	Shërbim larje automjeti “Hyundai Santa Fe”	Larje/muaj	4
5	Larje tapicerie automjetesh	Larje/vit	7

Kritere për kualifikim:

- Operatori ekonomik duhet të jetë brenda qytetit të Tiranës dhe të jetë brenda 2.5 km nga vendodhja e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për këtë pikë i referohemi ekstraktit të QKB-së.
- Operatori ekonomik do ta ofrojë këtë shërbim për një afat 12 mujor nga nënshkrimi i kontratës.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentat për plotësimin e kriterëve si më poshtë:

1. Dokumentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas të cilit në fushën e veprimtarisë së tij ka dhe objektin e prokurimit.
2. Dokument që nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv);
3. Dokument që nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP,
4. Nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
5. Dokument që ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LLP.
Operatori ekonomik duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër edhe nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklaratë me shkrim.
6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin e ofertës në të cilën duhet të përcaktohen çmimet për çdo zë dhe në total për shërbimet e kërkuara; vendodhja e saktë e lavazhit; të dhëna të plota të personit të kontaktit (emër, mbiemër, nr.cel, adresë emaili).
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike.
8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet Vërtetimi nga Administrata Tatimore ku të tregohet numri i punonjësve dhe listëpagesat për 3 muajt e fundit.
9. Dëshmi/vërtetime për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar është jo më pak se 153,000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Operatori ekonomik duhet të ketë në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet. Autoriteti kontraktor do të verifikojë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nëse e ka objekt të ushtrimit të veprimtarisë së tij. Nëse pas verifikimeve rezulton se, ndonjë nga operatorët ekonomik nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet automatikisht nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Referuar njoftimit të përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Nr. 8480 Prot, datë 30.12.2020, për nënshkrimin e një kontrate publike operatori ekonomik duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës elektronike për fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softuerike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit brenda 24 orëve, nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), me dokumentacionin provues, sipas kërkesave të mësipërme. Në të kundërt, do të bëhet kalimi dhe njoftimi i ofertuesit të radhës i kualifikuar në SPE e kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë, bazuar në nenin 56, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR